



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Nr. 1832/5 prot**

**Datë 04.11.2021**

**V E N D I M**  
**K.P.P. 848/2021**

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 04.11.2021 shqyrtoi ankesën me:

**Objekt:** Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Fedos” SHPK nga procedura e prokurimit me Nr. REF-97582-06-07-2021, me objekt: Loti 10 – “Pajisje Kardiake” me fond limit 1,676,885.73 lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 16.08.2021 nga autoriteti kontraktor, Qendra Spitalore Universitare Nënë Tereza Tiranë.

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Biometric Albania” SHPK në procedurën e prokurimit të sipërcituar.

**Ankimues:** Operatori ekonomik “Fedos” SHPK  
*Adresa: Rruga “Manol Konomi”, Nd. 14, Ap. 2, Tiranë*

Operatori ekonomik “Biometric Albania” SHPK  
*Rruga “Vllazën Huta”, Pall.Vila Park 1/6/25, Tiranë*

**Autoriteti Kontraktor:** Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza”  
*Adresa: Rruga “Dibrës” Nr. 372, Tiranë*

**Baza Ligjore:** Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi nr.914 datë 29.12.2014 i Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit

Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

**Vëren:**

**I**

*Vlerësimi paraprak*

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatorët ekonomik ankimes kanë *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatorët ekonomik ankimes kanë paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. Operatori ekonomik ankimes “Fedos” SHPK me ankesën nr. 1832 prot., datë 29.09.2021 nuk ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

I.5. Operatori ekonomik ankimes “Fedos” SHPK me ankesën nr. 1982 prot., datë 15.10.2021 nuk ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

I.6. Operatori ekonomik ankimes “Biometric Albania” SHPK ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

**II**

*Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 07.06.2021 është publikuar në faqen e internetit të Agjencisë së Prokurimit Publik, SPE, procedura e prokurimit me Nr. REF-97582-06-07-2021, me objekt: Loti 10 – “Pajisje Kardiake” me fond limit 1,676,885.73 lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 16.08.2021 nga autoriteti kontraktor, Qendra Spitalore Universitare Nënë Tereza, Tiranë.

II.2. Në datën 16.08.2021 autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

II.3. Në datën 23.09.2021, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

- “Fedos” SHPK	1 400 000	lekë	I skulifikuar
- “O.E.S Distrimed” SHPK	pa ofertë ekonomike		I skualifikuar
- “Montal” SHPK	pa ofertë ekonomike		I skualifikuar
- “Biometric Albania ” SHPK	927 000	lekë	I skualifikuar
- “BNT Electronics” SHPK	1 378 700	lekë	I skualifikuar
- “Ismometric” SHPK	1570 000	lekë	I skualifikuar

II.4. Referuar materialeve të fashikullit të shqyrtimit administrativ, rezulton se në datën 29.09.2021 operatori ekonomik ankimues “Fedos” SHPK, ka paraqitur ankesën pranë Komisionit të Prokurimit Publik, duke kundërshtuar vendimin e KVO-së mbi skualifikimin e ofertës së tij në procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

II.5. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe me anë të formularit të publikimit janë publikuar arsyet e skualifikimit të ankimuesit për të cilat ai ngre pretendime.

II.6. Referuar informacionit të paraqitur nga autoriteti kontraktor rezulton, se në datën 29.09.2021 operatori ekonomik ankimues “Fedos” SHPK ka paraqitur ankesën pranë autoritetit kontraktor me të njëjtin objekt si në ankesën e paraqitur pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

II.7. Me anë të shkresës nr. 1832/3 prot., datë 11.10.2021, Komisioni i Prokurimit Publik i ka kërkuar autoritetit kontraktor të dërgojë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, informacion të hollësishëm mbi procedurën e mësipërme të prokurimit, për procesin e shqyrtimit dhe vlerësimit të ofertave, të jepen argumentimet përkatëse mbi pretendimet e operatorit ekonomik “Fedos” SHPK, si dhe vendimin e autoritetit kontraktor lidhur me trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

II.8. Me shkresën nr.2494/5 prot., datë 15.10.2021., protokolluar me tonën nr. 1832/4 prot., datë 18.10.2021 autoriteti kontraktor njofton Komisionin e Prokurimit Publik se ka vendosur të mos marrë në shqyrtimin ankesën e operatorit ekonomik ankimues “Fedos” SHPK për procedurën e prokurimit objekt ankimi me arsyetimin se është paraqitur përpara afateve ligjore të ankimit.

II.9. Referuar sistemit elektronik të prokurimit me datë 07.10.2021 është publikuar njoftimi i anulimit të procedurës së prokurimit nga ana e autoritetit kontraktor.

II.10. Bazuar në materialet e fashikullit të shqyrtimit administrativ, rezulton se në datën 15.10.2021 operatori ekonomik ankimues “Fedos” SHPK, ka paraqitur ankesën pranë Komisionit të Prokurimit Publik, duke kundërshtuar vendimin e KVO-së mbi skualifikimin e ofertës së tij në procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

II.11. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të

plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe me anë të formularit të publikimit janë publikuar arsyet e skualifikimit të ankimuesit për të cilat ai ngre pretendime.

II.12. Referuar informacionit të paraqitur nga autoriteti kontraktor rezulton, se në datën 13.10.2021 operatori ekonomik ankimues “Fedos” SHPK, ka paraqitur ankesën pranë autoritetit kontraktor me të njëjtin objekt si në ankesën e paraqitur pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

II.13. Me shkresën nr.2616/8 prot., datë 25.10.2021., protokolluar me tonën nr. 1982/3 prot., datë 28.10.2021 autoriteti kontraktor njofton Komisionin e Prokurimit Publik, se ka vendosur të pranojë ankesën e operatorit ekonomik ankimues “Fedos” SHPK për procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

II.14. Në datën 23.09.2021, operatori ekonomik “Biometric Albania” SHPK është njoftuar elektronikisht për skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi, me arsyetimin si më poshtë;

*“Bazuar në Ligjin Nr162/2020, “Për Prokurimin Publik”, neni 93 dhe neni 66 pika 5 e VKM nr. 914 datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar sipas të cilit: Në rastin kur janë të vlefshme dy ose më pak oferta, në përputhje me nenin 56 të LPP (Neni 93,Ligji 162/2020), oferta vlerësohet anomalisht e ulët kur ajo është ulur më shumë se 25% e fondit limit të përlllogaritur, KVO ka përlllogaritur se Oferta e OE “Biometric Albania” ShPK, rezulton të jetë anomalisht e ulët. Për këtë arsye KVO ju drejtua në SPE për argumentimin e ofertës anomalisht të ulët si më poshtë: Në vijim të vlerësimit të bërë për procedurën e prokurimit: “F.V Aparatura Mjekësore, Mobilimi dhe Hotelerie për Godinën e Re të Pediatrisë, Ndërtuar me Kredi të Bankës Botërore”; i ndare ne lote (22 lote gjithsej), “Procedurë e Hapur” dhe bazuar ne VKM 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”, Neni 66 Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave , pika 5: 5)Pas korrigjimit të gabimeve aritmetike, komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon nëse ofertat e vlefshme janë ose jo me çmim anomalisht të ulët sipas formulës së përcaktuar në dokumentet standarde të tenderit. Përlllogaritja e ofertës anomalisht të ulët bëhet në mënyrat e mëposhtme: - Në rastin kur janë të vlefshme dy ose më pak oferta, në përputhje me nenin 56 të LPP (Neni 93,Ligji 162/2020), oferta vlerësohet anomalisht e ulët kur ajo është ulur më shumë se 25% e fondit limit të përlllogaritur. - Në rastin kur janë të vlefshme tre ose më shumë oferta, në përputhje me nenin 56 të LPP(Neni 93,Ligji 162/2020), oferta vlerësohet anomalisht e ulët nëse vlera e saj do të jetë më e vogël se 85% e mesatares së ofertave të vlefshme. Gjatë shqyrtimit te ofertes tuaj ekonomike, rezulton se oferta me vlere totale: 927,000 është ofertë anomalisht e ulët. Sa më sipër, lutemi të paraqisni me shkrim, sqarimet dhe argumentimet për ofertën anomalisht të ulët. Afati per te dhene sqarimet/shpjegimet perkatese do të jetë deri në dt.24.09.2021 (e Premte) ora 12:00. KVO administroi dokumentacion (bashkëlidhur) dhe vlerësoi se nuk plotëson kushtet dhe formen ligjore për tu konsideruar si Ofertë e vlefshme pasi OE nuk ka dorezuar asnje dokument provues bashkengjitur analizes se tij te cmimit ne menyre qe te krijoje bindjen e AK per vlefshmerine e ofertes. I vetmi dokument bashkelidhur eshte nje tabele cmimesh e cila nuk permban firme apo vule te prodhuesit ne menyre qe te provoje vertetesine e dokumentit.”*

II.15. Bazuar në materialet e fashikullit të shqyrtimit administrativ, rezulton se në datën 12.10.2021 operatori ekonomik ankimues “Biometric Albania” SHPK, ka paraqitur ankesën pranë Komisionit të Prokurimit Publik, duke kundërshtuar vendimin e KVO-së mbi skualifikimin e ofertës së tij në procedurën e prokurimit objekt ankimi.

II.16. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe me anë të formularit të publikimit janë publikuar arsyet e skualifikimit të ankimuesit për të cilat ai ngre pretendime.

II.7. Referuar informacionit të paraqitur nga autoriteti kontraktor rezulton, se në datën 12.10.2021 operatori ekonomik ankimues “Biometric Albania” SHPK ka paraqitur ankesën pranë autoritetit kontraktor me të njëjtin objekt si në ankesën e paraqitur pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

II.8. Me shkresën nr.2609/11 prot., datë 27.10.2021, protokolluar me tonën nr. 1927/4 prot., datë 27.10.2021, autoriteti kontraktor njofton Komisionin e Prokurimit Publik, se ka vendosur të mos pranojë ankesën e operatorit ekonomik ankimues “Biometric Albania” SHPK për procedurën e prokurimit objekt-ankimi me argumentin se “[...] Në rastin në fjalë OE nuk ka paraqitur anën ekonomike të ndërtimit të ofertës në mënyrë të saktë dhe të mbështetur në dokumentacion teknik dhe ligjor që të krijojë bindjen tek AK për rregullsinë e ofertës së paraqitur”.

### III

#### Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit paraprak të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, si edhe informacionit të autoritetit kontraktor,

#### Arsyeton

III.1. Në datën 07.06.2021 është publikuar në faqen e internetit të Agjencisë së Prokurimit Publik, SPE, procedura e prokurimit me Nr. REF-97582-06-07-2021, me objekt: Loti 10 – “Pajisje Kardiake” me fond limit 1,676,885.73 lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 16.08.2021 nga autoriteti kontraktor, Qendra Spitalore Universitare Nënë Tereza, Tiranë.

III.2. Në datën 16.08.2021 autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

III.3. Në datën 23.09.2021, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

- “Fedos” SHPK	1 400 000	lekë	I skulifikuar
- “O.E.S Distrimed” SHPK	pa ofertë ekonomike		I skualifikuar
- “Montal” SHPK	pa ofertë ekonomike		I skualifikuar
- “Biometric Albania ” SHPK	927 000	lekë	I skualifikuar
- “BNT Electronics” SHPK	1 378 700	lekë	I skualifikuar
- “Ismometric” SHPK	1 570 000	lekë	I skualifikuar

III.4. Referuar materialeve të fashikullit të shqyrtimit administrativ, rezulton se në datën 29.09.2021 operatori ekonomik ankimues “Fedos” SHPK, ka paraqitur ankesën pranë Komisionit të

Prokurimit Publik, duke kundërshtuar vendimin e KVO-së mbi skualifikimin e ofertës së tij në procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

III.5. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe me anë të formularit të publikimit nr. 1932/2 prot., datë 30.09.2021, janë publikuar arsyet e skualifikimit të ankimuesit për të cilat ai ngre pretendime.

III.6. Referuar informacionit të paraqitur nga autoriteti kontraktor rezulton, se në datën 29.09.2021 operatori ekonomik ankimues “Fedos” SHPK, ka paraqitur ankesën pranë autoritetit kontraktor me të njëjtin objekt si në ankesën e paraqitur pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

III.7. Neni 24, pika 1, “Komisioni i prokurimit Publik” i Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikon se: *“Komisioni i Prokurimit Publik është organi më i lartë administrativ në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit dhe kryen çdo detyrë tjetër që i ngarkohet me këtë ligj dhe akte të tjera ligjore brenda fushës së kompetencave të tij.”*

III.7.1. Neni 30, pika 1, “Veprimtaria e Komisionit të Prokurimit Publik” i Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikon se: *“Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesat e paraqitura para tij kur në mbledhje janë të pranishëm të paktën 3 nga 5 anëtarët e tij, një prej të cilëve kryetari ose nënkryetari. Në përfundim të shqyrtimit të ankesave, Komisioni vendos me shumicë votash. Vendimi deklarativ i dhënë sipas parashikimeve të nenit 115, pikat 2 dhe 3, të këtij ligji, jepet nga 3 anëtarë për procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar dhe nga 5 anëtarët për procedurat e tjera. Shqyrtimi i ankesave për procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar do të bëhet nga 3 anëtarë të Komisionit të Prokurimit Publik”*.

III.7.2. Neni 110, pikat 2, 7 dhe 8 “Afatet për ankimim” i Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikon se: *“2. Në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të ankohen brenda 10 ditëve nga publikimi i njoftimit të fituesit ose publikimi i njoftimi të anulimit.*

*Në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar ky afat është 7 ditë.*

*7. Në rast se operatori ekonomik nuk paraqet ankesën brenda afateve të parashikuara në këtë nen, atëherë nuk ka mundësi të ushtrorë më të drejtën e ankimit pranë autoritetit ose entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.*

*8. Të shtunat, të dielat dhe ditët e festave zyrtare nuk pengojnë fillimin dhe kohëzgjatjen e afateve. Kur dita e fundit e një afati bie e shtunë, e diel ose një ditë feste zyrtare, afati mbaron në ditën e punës që vjen pas saj. Ankesa quhet e pranuar në ditën e depozitimit të saj pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.”*

III.7.3. Neni 111, pika 1, i Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikon se: *“1. Operatori ekonomik ankimues dërgon njëkohësisht ankesën në autoritetin ose entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik. Rregulla të posaçme për mënyrën e paraqitjes së ankesës përcaktohen në rregullat e prokurimit publik.”*

III.7.4. Neni 112, pikat 1 dhe 2 i Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikon se: *“1. Me marrjen e ankesës, autoriteti ose enti kontraktor konfirmon në databazën e të dhënave të publikuara nga Komisioni i Prokurimit Publik që ankesa është paraqitur pranë këtij institucioni. Nëse autoriteti ose enti kontraktor konstaton se ankesa nuk është paraqitur në Komisionin e Prokurimit Publik, e refuzon atë si të pavlefshme.*

*2. Pasi konfirmon se ankesa është paraqitur në Komisionin e Prokurimit Publik, autoriteti ose enti kontraktor pezullon vazhdimin e procedurës së prokurimit deri në shqyrtimin plotësisht të ankesës, përfshirë edhe nxjerrjen e një vendimi nga Komisioni i Prokurimit Publik.”*

III.7.5. Referuar bazës ligjore të sipërcituar, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se afati për dorëzimin e ankesës pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor, në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për kundërshtimin e vendimit të KVO-së lidhur me vlerësimin/klasifikimin përfundimtar, është 7 ditë nga publikimi i njoftimit të fituesit ose i njoftimit të anulimit. Në rastin konkret operatori ekonomik ankimues “Fedos” SHPK, ka dorëzuar ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik me datë 29.09.2021. Ndërkohë sipas verifikimeve në Sistemin Elektronik të Prokurimit, për këtë procedurë prokurimi nuk ka asnjë operator ekonomik të kualifikuar dhe referuar nenit 98 “Anulimi i një procedure prokurimi” pika 1 shkronja “b” të ligjit nr. 162/2020 datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” ku parashikohet se *“1. Autoriteti ose enti kontraktor anulon procedurën e prokurimit në rastet kur: b) në procedurat me një fazë nuk është dorëzuar asnjë ofertë e përshtatshme”* u konstatua se nga ana e autoritetit kontraktor njoftimi i anulimit për këtë procedurë prokurimi është kryer me datë 07.10.2021.

Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se operatori ekonomik ankimues ka dorëzuar ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe pranë Komisionit të Prokurimit Publik përpara afatit të parashikuar nga neni 110, pika 2 e Ligjit 162/2020 “Për prokurimin publik”, i cili parashikon se: *“2. Në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimin/klasifikimin përfundimtar, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të ankohen brenda 10 ditëve nga publikimi i njoftimit të fituesit ose publikimi i njoftimit të anulimit. Në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar ky afat është 7 ditë.”*, pasi në datë 29.09.2021 (data që ankimuesi ka paraqitur ankesën respektivisht ne KPP dhe autoritet kontraktor) nga ana e autoritetit kontraktor nuk ishte publikuar njoftimi i anulimit të procedurës së prokurimit objektiv ankimi.

Referuar parashikimeve të sipërcituara, llogaritja e afatit për ankim pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, kundër vendimeve të autoritetit kontraktor lidhur me vlerësimin e procedurës së prokurimit, nis ditën e publikimit të njoftimit të fituesit ose publikimit të njoftimit të anulimit dhe përfundon në ditën e 7-të për shkak se procedura e prokurimit referuar vlerës duke u bazuar në nenin 8 “Kufijtë monetarë” të VKM nr. 914, datë 24.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar (si akti nën ligjor në fuqi në momentin e publikimit të procedurës së prokurimit” është nën kufirin e lartë monetar. Në rastin konkret, në datë 29.09.2021 afati i paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe njëkohësisht pranë Komisionit të Prokurimit Publik nuk kishte filluar, për sa kohë nuk ishte publikuar njoftimi i anulimit të procedurës së prokurimit, që do të thotë se ankimuesit nuk i kishte lindur akoma e drejta e ankimit.

Për sa më sipër, ankesa e depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik dhe autoritetin kontraktor në datë 29.09.2021, konsiderohet e paraqitur përpara afatit ligjor të ankimimit, duke

mos u legjitimuar *ratione temporis*. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se ligji *stricto sensu* ka parashikuar, se ankesa dorëzohet njëherazi si pranë autoritetit ose entit kontraktor ashtu edhe pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe është përgjegjësi e operatorit ekonomik ankimues, që të dorëzojë këtë të fundit njëherazi në të dyja institucionet, brenda afatit të parashikuar në ligj.

III.7.6. Sa më sipër arsyetuar, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se ankesa e dorëzuar nga operatori ekonomik ankimues, nuk ka përmbushur detyrimin për ndjekjen e afateve ligjore të ankimit, ndaj përbën shkak për mospranimin e ankesës nga ana e Komisionit të Prokurimit Publik. Komisioni i Prokurimit Publik rithekson bindjen e tij, se për shkak të specifikës së prokurimeve publike, respektimi i afateve, është i një rëndësie thelbësore e me ndikim të drejtpërdrejtë në efikasitetin e procedurës, ndaj edhe i qëndron strikt rregullit të parashikuar nga ligji i prokurimit publik si *lex specialis* mbi lëndën.

Sa më lart ankesa e paraqitur nga operatori ekonomik akimues “Fedos” SHPK nuk pranohet.

III.8. Referuar sistemit elektronik të prokurimit me datë 07.10.2021 është publikuar anulimi i procedurës së prokurimit objekt-ankimi nga ana e autoritetit kontraktor.

III.9. Bazuar në materialet e fashikullit të shqyrtimit administrativ, rezulton se në datën 15.10.2021 operatori ekonomik ankimues “Fedos” SHPK, ka paraqitur ankesën pranë Komisionit të Prokurimit Publik, duke kundërshtuar vendimin e KVO-së mbi skualifikimin e ofertës së tij në procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

III.10. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe me anë të formularit të publikimit janë publikuar arsyet e skualifikimit të ankimuesit për të cilat ai ngre pretendime.

III.11. Referuar informacionit të paraqitur nga autoriteti kontraktor rezulton, se në datën 13.10.2021 operatori ekonomik ankimues “Fedos” SHPK ka paraqitur ankesën pranë autoritetit kontraktor me të njëjtin objekt si në ankesën e paraqitur pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

III.12. Me shkresën nr.2616/8 prot., datë 25.10.2021., protokolluar me tonën nr. 1982/3 prot., datë 28.10.2021 autoriteti kontraktor njofton Komisionin e Prokurimit Publik, se ka vendosur të pranojë ankesën e operatorit ekonomik ankimues “Fedos” SHPK, për procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

III.13. Në nenin 110, pikat 2, 7 dhe 8 “Afatet për ankimit” të Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikon shprehimisht se: “2. Në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të ankohen brenda 10 ditëve nga publikimi i njoftimit të fituesit ose publikimi i njoftimi të anulimit.

Në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar ky afat është 7 ditë.



7. Në rast se operatori ekonomik nuk paraqet ankesën brenda afateve të parashikuara në këtë nen, atëherë nuk ka mundësi të ushtrojë më të drejtën e ankimit pranë autoritetit ose entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

8. Të shtunat, të dielat dhe ditët e festave zyrtare nuk pengojnë fillimin dhe kohëzgjatjen e afateve. Kur dita e fundit e një afati bie e shtunë, e diel ose një ditë feste zyrtare, afati mbaron në ditën e punës që vjen pas saj. Ankesa quhet e pranuar në ditën e depozitimit të saj pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.”.

III.8.6. Në nenin 134 pika 2 të ligjit nr.162/2020 ” Për prokurimin publik”, parashikohet se ”Aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, që nuk bien në kundërshtim me këtë ligj, do të zbatohen deri në nxjerrjen e akteve nënligjore në zbatim të këtij ligji. Çdo akt tjetër nënligjor, që bie në kundërshtim me këtë ligj, shfuqizohet”. Kështu, në nenin 8 pika 1 të Vendimit nr.914 datë 29.12.2014 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, si akt në fuqi në momentin e publikimit të procedurës së prokurimit, parashikohet se: “1.Në përputhje me nenin 27 të LPP kufijtë monetarë janë:

a) Kufiri i lartë monetar:

-2.400.000.000 (dy miliard e dyqind milionë) lekë për kontratat e punëve publike;

-200.000.000 (dyqind milionë) lekë për kontratat publike të shërbimeve dhe mallrave.

b) Kufiri i ulët monetar:

- 12.000.000 (dymbëdhjetë milionë) lekë për kontratat e punëve publike;

- 8.000.000 (tetë milionë) lekë për kontratat publike të shërbimeve dhe të mallrave.

Të njëjtët kufij monetarë zbatohen edhe për kontratat sektorale.”

III.8.7. Në nenin 111, pika 1, të Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se: “1. Operatori ekonomik ankimues dërgon njëkohësisht ankesën në autoritetin ose entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik. Rregulla të posaçme për mënyrën e paraqitjes së ankesës përcaktohen në rregullat e prokurimit publik.”.

Neni 112, pikat 1 dhe 2 të Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikon shprehimisht se: “1. Me marrjen e ankesës, autoriteti ose enti kontraktor konfirmon në databazën e të dhënave të publikuara nga Komisioni i Prokurimit Publik që ankesa është paraqitur pranë këtij institucioni. Nëse autoriteti ose enti kontraktor konstaton se ankesa nuk është paraqitur në Komisionin e Prokurimit Publik, e refuzon atë si të pavlefshme.

2. Pasi konfirmon se ankesa është paraqitur në Komisionin e Prokurimit Publik, autoriteti ose enti kontraktor pezullon vazhdimin e procedurës së prokurimit deri në shqyrtimin plotësisht të ankesës, përfshirë edhe nxjerrjen e një vendimi nga Komisioni i Prokurimit Publik.”.

III.8.8. Bazuar në verifikimet në SPE, ku rezulton se procedura e prokurimit është kombëtare, si dhe referuar bazës ligjore të sipërcituar, në rastin konkret, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se afati për dorëzimin e ankesës pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor, do të përlllogaritet sipas përcaktimeve për procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar, duke e lidhur fillimin e të drejtës së ankimit me ditën e publikimit të njoftimit të fituesit ose publikimit të njoftimit të anulimit dhe përfundimin e saj në ditën e 7-të. Sipas verifikimeve në Sistemin Elektronik të Prokurimit, për këtë procedurë prokurimi nuk ka asnjë operator ekonomik të kualifikuar dhe referuar nenit 98 “Anulimi i një procedure prokurimi” pika 1 shkronja “b” të ligjit nr. 162/2020

datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” ku parashikohet se “1. Autoriteti ose enti kontraktor anulon procedurën e prokurimit në rastet kur: b) në procedurat me një fazë nuk është dorëzuar asnjë ofertë e përshtatshme”, u konstatua se nga ana e autoritetit kontraktor është publikuar njoftimi i anulimit për këtë procedurë prokurimi me datë 07.10.2021, ndërkohë që operatori ekonomik ankimes “Fedos” SHPK, ka dorëzuar ankesë pranë autoritetit kontraktor me datë 13.10.2021 dhe pranë Komisionit të Prokurimit Publik në datën 15.10.2021.

Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se operatori ekonomik ankimes ka dorëzuar ankesë pranë autoritetit kontraktor brenda afatit ligjor për ankim ndërsa pranë Komisionit të Prokurimit Publik jashtë afatit ligjor të parashikuar nga neni 110, pika 2 e Ligjit 162/2020 “Për prokurimin publik”, i cili parashikon se “2. Në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të ankohen brenda 10 ditëve nga publikimi i njoftimit të fituesit ose publikimi i njoftimit të anulimit. Në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar ky afat është 7 ditë”

Referuar parashikimeve të sipërcituara, në rastin konkret llogaritja e afatit për ankim pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, për ankesat për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar, nis ditën e publikimit të njoftimit të anulimit dhe përfundon ditën e 7-të. Duke u bazuar në faktin që ankimesi është vënë në dijeni më anë të SPE mbi anulimin e procedurës së prokurimit objekt-ankimi me datë 07.10.2021, pohuar kjo edhe në ankesë nga vetë operatori ekonomik ankimes, afati maksimal i paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe njëkohësisht pranë Komisionit të Prokurimit Publik është data 13.10.2021.

Për sa më sipër, ankesa e depozituar në autoritetin kontraktor në datën 13.10.2021, konsiderohet e paraqitur brenda afatit ligjor të ankimimit, ndërsa ankesa e depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik në datën 15.10.2021 jashtë afatit ligjor të ankimimit duke mos u legjitimuar *ratione temporis*. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, ligji *stricto sensu* ka parashikuar, se ankesa dorëzohet njëherazi, si pranë autoritetit ose entit kontraktor ashtu edhe pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe është përgjegjësi e operatorit ekonomik ankimes, që të dorëzojë këtë të fundit njëherazi në të dyja institucionet, brenda afatit të parashikuar në ligj.

III.9.9. Sa më sipër arsyetuar, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se ankesa e dorëzuar nga operatori ekonomik ankimes, nuk ka përmbushur detyrimin për ndjekjen e afateve ligjore të ankimimit, ndaj përbën shkak për mospranimin e ankesës nga ana e Komisionit të Prokurimit Publik. Komisioni i Prokurimit Publik rithekson bindjen e tij, se për shkak të specifikës së prokurimeve publike, respektimi i afateve, është i një rëndësie thelbësore e me ndikim të drejtpërdrejtë në efikasitetin e procedurës, ndaj edhe i qëndron strikt rregullit të parashikuar nga ligji i prokurimit publik si *lex specialis* mbi lëndën.

Sa më sipër ankesa e operatorit ekonomik “Fedos” SHPK nuk pranohet.

III.10. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimes “Biometric Albania” SHPK mbi skualifikimin e tij nga procedura e prokurimit objekt ankimi me argumentin se: “[...]Gjatë shqyrtimit të ofertes tuaj ekonomike, rezulton se oferta me vlere totale: 927,000 është ofertë anomalisht e ulët. Sa më sipër, lutemi të paraqisni me shkrim, sqarimet dhe argumentimet për ofertën anomalisht të ulët. Afati për të dhene sqarimet/shpjegimet perkatese do të jetë deri në dt.24.09.2021 (e Premte) ora 12:00. KVO administroi dokumentacion (bashkëlidhur) dhe vlerësoi se nuk plotëson kushtet dhe formen ligjore për tu konsideruar si Ofertë e vlerfshme pasi OE nuk ka dorëzuar asnjë dokument provues bashkengjitur analizes se tij te cmimit ne menyre qe

te krijoje bindjen e AK per vlefshmerine e ofertes. I vetmi dokument bashkëlidhur është një tabelë cmimesh e cila nuk përmban firme apo vule të prodhuesit në mënyrë që të provojë vërtetësinë e dokumentit.” KPP vëren se,

III.11. Në shtojcën 12 të dokumenteve të tenderit (loti 10) përcaktohet si më poshtë:

*Loti 10 Pajisje Kardiake*

<b>Loti 10 Pajisje Kardiake</b>		
<b>Nr.</b>	<b>Produkti</b>	<b>Sasia</b>
1	Defibrilator	2
2	EKG	1

*Garancia*

*Deklarate per permbushjen e afatit te garancise: 3 vite nga marrja në dorëzim nga Autoriteti Kontraktor. (Bazuar në eksperiencën e F.V. të pajisjeve mjekësore të PAI Polivalent, duke qene se eshte e njejta natyre pajisjesh mjekesore)*

*Kohëzgjatja e kontratës ose afati kohor për ekzekutimin:*

*Afatet e ekzekutimit: Furnizimi dhe vendosja e Pajisjeve Mjekësore (Për lotet nga Loti 1 deri në Lotin 22) në Godinën e Re të Pediatriisë në QSU “Nënë Tereza”, sipas të gjitha Specifikimeve të mësipërme do të kryhet maksimumi për 45 ditë kalendarike, nga lidhja e kontratës.*

*Afati i kohezgjatjes së Marrëveshjes Kuader është 12 muaj.”*

III.1.2. Referuar materialeve të fashikullit të shqyrtimit administrativ rezultojnë se autoriteti kontraktor i ka kërkuar operatorit ekonomik ankimues ‘Biometric Albania’ SHPK sqarimet dhe argumentimet për ofertën anomalisht të ulët për ti paraqitur deri në datën 24.09.2021 ora 12:00.

III.1.3. Më synim justifikimin/argumentimin e ofertës anomalisht të ulët është paraqitur dokumentacioni si më poshtë:

- Shkresë e datës 22.09.2021 me lëndë: “Analizë e cmimit të ofertës me objekt : “Loti 10- Pajisje kardiake” me REF-97582-06-07-2021” me përmbajtje si vijon: [.....] OE Biometric Albania SHPK ka ofretuar për procedurën e sipërpërmendur produktet e listuara më poshtë për të cial po paraqesim kuotimin nga firma prodhuese përkatëse sipas modeleve që përmbushin specifikimet teknike dhe kërkesat e paraqitura në DST.:

<i>Nr</i>	<i>Emertimi</i>	<i>Njësia</i>	<i>Sasia</i>	<i>prodhues</i>	<i>Cmimi blerje</i>	<i>Vlera blerje</i>	<i>Konvertimi në lekë</i>
1	Defibrilator	copë	2	Mindray	X USD	X USD	X
2	EKG	copë	1	Mindray	X USD	X USD	X
						<i>Totali</i>	<i>X</i>

*Kursi i këmbimit në datën e zhvillimit të tenderit (16.08.2021): 1 USD=103.03. lekë*

*Vlera e përlogaritur për transport nga vendi i origjinës (Kinë) për volumet përkatëse + shpenzimet doganore+ Deklarata dhe dokumentacion si dhe shpenzime transport i brendshëm =61800 lekë*

*Pra kosto totale =817422 lekë*

*Oferta ekonomike OE Biometrik Albania ka qenë në vlerën 927000 lekë pra norma e fitimit është llogaritur rreth 13% në shitje. Pra siç shihet në të gjitha rastet OE Biometric Albania ka përlogaritur në cmimin e ofertimit të gjitha kostot e blerjes së mallit kostot e tjera të nevojshme transport, doganë e tij për furnizimin dhe vendosjen e këtyre pajisjeve mjekësore.*

*Ju vëmë në dukje faktin që: Duke qenë se në autoritetin tuaj kontraktor janë instaluar në vitet e kaluara shumë pajisje të kompanisë së mirënjohur prodhuese Mindray (si Ventilatore, Monitore pacienti, Shiringa elektrike, defibrilatore etj) kjo kompani ka marrë parasysh kërkesën tonë për suportim në këtë procedurë prokurimi dhe në vlerësimi të institucionit tuaj si qender reference e rëndësishme për institucionet e tjera spitalore (private apo publike) si dhe duke shpresuar për një bashkëpunim të mëtijshëm për të promovuar modelet më të fundit të defibrilatorëve dhe EKG na ka siguruar për këtë procedurë prokurimi një cmim preferencial të vecantë duke aplikuar zbritje shtesë 20% mbi zbritjen normale të distributorit.*

*Pra cmimi i ofruar nga ana e OE Biometric Albania është i bazuar në kostot reale të blerjes së këtyre produkteve dhe na siguron ne si operator ekonomik një fitim normal dhe jo të lartë dhe abuziv.*

*Në cdo rast jemi përpjekur të optimizojmë kostot tona të blerjes dhe të përlogarisim në detaje kostot e transportit dhe të gjitha kostot e tjera shtesë dhe të ofrojmë një çmim që të na mundësojë të jemi konkurrues në treg. Si përfundim ritheksojmë dhe garantojmë cilësinë e produkteve të ofruara dhe përmbushjen e specifikimeve sipas dokumenteve standarde të tenderit nën emrin dhe eksperiencën tonë 28 vjeçare në treg.*

*Për të plotësuar këtë argumentim lutem gjeni bashkëlidhur listën e çmimeve të kompanisë prodhuese e cila na ka autorizuar në këtë procedurë dhe që sqaron dhe ofertën totale t OE Biometric albania në këtë rast.”*

*- Listën e çmimeve të kompanisë prodhuese*

*- Deklaratë e datës 13.09.2021 e prodhuesit Mindray.*

III.1.4. Në nenin 93 pika 1 dhe 2 të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” përcaktohet se:

*“1. Kur autoritetet ose entet kontraktore vërejnë se oferta për punët, furnizimet ose shërbimet është anomalisht e ulët, i kërkon operatorit ekonomik të paraqesë me shkrim dhe brenda tri ditëve pune shpjegime për çmimin ose kostot e propozuara në ofertë.*

*2. Shpjegimet e përmendura në pikën 1 jepen veçanërisht për:*

*a) anën ekonomike të procesit të prodhimit, të shërbimeve të ofruara ose të metodës së ndërtimit;*

*b) zgjidhjet teknike të përzgjedhura dhe/ose ndonjë kusht favorizues të jashtëzakonshëm që ka ofertuesi për furnizimin e produkteve ose shërbimeve ose për kryerjen e punës;*

*c) origjinalitetin e punës, furnizimeve ose shërbimeve të propozuara nga ofertuesi;*

*ç) pajtueshmërinë me detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fushën e mjedisit, në fushën sociale dhe të punës;*

*d) mundësinë e ofertuesit për të marrë ndihmë shtetërore.*

*3. Autoriteti ose enti kontraktor vlerëson informacionin e dhënë, duke u konsultuar me ofertuesin. Ai mund ta refuzojë ofertën kur, edhe pas shqyrtimit të provave të dhëna nga ofertuesi, nuk bindet se ajo është e rregullt në të gjitha elementet e saj [...]”*

III.1.5. Në nenin 66 pika 5 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.914 datë 29.12.2014 “ Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar (si akti nënligjor në fuqi në momentin e publikimit të procedurës së prokurimit) parashikohet se “*Pas korigjimit të gabimeve aritmetike, komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon nëse ofertat e vlefshme janë ose jo me çmim anomalisht të ulët sipas formulës së përcaktuar në dokumentet standarde të tenderit. Përlllogaritja e ofertës anomalisht të ulët bëhet në mënyrat e mëposhtme: Në rastin kur janë të vlefshme dy ose më pak oferta, në përputhje me nenin 56 të LPP, oferta vlerësohet anomalisht e ulët kur ajo është ulur më shumë se 25% e fondit limit të përlllogaritur. Në rastin kur janë të vlefshme tre ose më shumë oferta, në përputhje me nenin 56 të LPP, oferta vlerësohet anomalisht e ulët nëse vlera e saj do të jetë më e vogël se 85% e mesatares së ofertave të vlefshme. Nëse një apo disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, komisioni I vlerësimit të ofertave duhet të kërkojë sqarime nga ofertuesit, përpara se të marrë vendim për kualifikimin ose jo të tyre, në përputhje me nenin 56 të LPP. Në çdo rast ofertuesi ka detyrimin të argumentojë dhe të dokumentojë me prova shkresore sqarimet për elementin/elementet e veçanta të ofertës, në përputhje me kërkesat e nenit 56 të LPP. [...]*

III.1.6. Nga shqyrtimi i ofertës ekonomike të operatorit ekonomik “Biometric Albania” SHPK, si edhe nga përlllogaritjet e kryera, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton, se oferta ekonomike në vlerën prej 927000 lekë pa TVSH, në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, rezulton anomalisht e ulët. Sa më sipër, K.P.P gjykon se autoriteti kontraktor ka vepruar drejt kur gjatë periudhës së vlerësimit të ofertave i ka kërkuar informacion të detajuar operatorit ekonomik “Biometric Albania” SHPK mbi argumentimin e ofertës anomalisht të ulët, referuar kjo nenit 93 të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, por edhe jurisprudencës së Gjykatës Europiane të Drejtësisë (në vijim GJED), ku në çështjen C-599/10 SAG ELV Slovensko dhe të tjerë, GJED-ja vendosi që autoriteti kontraktor ishte i detyruar që të kërkonte nga një operator ekonomik që të sqaronte një ofertë anomalisht të ulët (paragrafët 32-34). Gjithashtu vendimi i autoritetit kontraktor për ti kërkuar operatorit ekonomik sqarim mbi argumentimin e ofertës anomalisht të ulët është në përputhje me nenin 69 të Direktivës 24/2014 “Për prokurimin publik” KE, që lidhet me ofertat anomalisht të ulëta dhe nga ku përputhshmëria e *lex specialis* për prokurimin publik me nenin 69 të Direktivës në lidhje me ofertën anomalisht të ulët është e plotë. Komisioni i Prokurimit Publik thekson faktin, që shpjegimet e operatorëve ekonomik për ofertën anomalisht të ulët duhet të lidhen me kushtet e përcaktuara në pikën 2 të nenit 93 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, nga ku katër kushtet e para janë të natyrës kumulative, në kuptimin që ato duhet të plotësohen njëkohësisht dhe në këtë vështrim, mjafton mosplotësimi i njërit prej tyre që operatori ekonomik të dështojë në argumentimin mbi paraqitjen e ofertës anomalisht të ulët, ndërsa kushti i pestë lidhet me *mundësinë* e ofertuesit për të marrë ndihmë shtetërore çfarë do të thotë, që jo çdo ofertues mund ta sigurojë këtë ndihmë dhe si rrjedhojë në ato raste kur ajo nuk është e mundur të sigurohet, mosplotësimi i këtij kushti nuk përbën shkak për dështimin e operatorit në argumentimin e ofertës anomalisht të ulët, nëse operatori ekonomik ofertues ka arritur të argumentojë/provojë me dokumente shkresore plotësimin e katër kushteve të para kumulative të përcaktuara në shkronjat “a”, “b”, “c” “ç” të pikës 2 të nenit 93 të *lex specialis*.

Nga interpretimi literal i nenit 93 pika 1 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” Komisioni i Prokurimit Publik konstaton, se barra e provës mbi argumentin e ofertës anomalisht të ulët i përket operatorit ekonomik, oferta e të cilit është konstatuar nga Komisioni i Vlerësimit të

Ofertave si anomalisht e ulët në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar (si akti nënligjor në fuqi në momentin e publikimit të procedurës së prokurimit). Gjithashtu, K.P.P gjykon se argumentimi i ofertës anomalisht të ulët njëherazi duhet të plotësojë katër kushte kumulative si dhe *mundësinë* për plotësimin e kushtit të pestë, për ti dhënë garanci si edhe bindje autoritetit kontraktor se operatori ekonomik do të përmbushë me sukses kontratën. Së pari, operatori ekonomik ankimes duhet të dorëzojë në mënyrë të detajuar anën ekonomike të metodës së ndërtimit, procesit të prodhimit ose të shërbimeve të ofruara, gjithashtu duhet të paraqesë para autoritetit kontraktor zgjidhjet teknike të përzgjedhura dhe/ose ndonjë kusht favorizues të jashtëzakonshëm që ka ofertuesi për furnizimin e produkteve ose shërbimeve, ose për kryerjen e punës. Gjithashtu është detyrë e operatorëve ekonomikë oferta e të cilëve është konstatuar anomalisht e ulët të paraqesin prova shkresore para autoritetit kontraktor në lidhje me origjinalitetin e punës, furnizimeve ose shërbimeve të propozuara nga ofertuesi. Ata duhet të vërtetojnë pajtueshmërinë me detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fushën e mjedisit, në fushën sociale dhe të punës, në vendin ku do të kryhet puna, shërbimi apo ku do të sigurohet furnizimi si edhe së fundmi të argumentojnë apo provojnë *mundësinë* e tyre për të përfituar ndihmë shtetërore. K.P.P gjykon se katër kushtet e para të përcaktuara në shkronjat “a”, “b”, “c” “ç” të pikës 2 të nenit 93 të *lex specialis* janë kushte kumulative të cilat më anë të provave shkresore dhe argumentimeve përkatëse duhen plotësuar nga operatorët ekonomikë ankimes, oferta e të cilëve rezulton anomalisht e ulët ndërsa kushti i përcaktuar në shkronjën “d” 2 të nenit 93 të *lex specialis* lidhet me *mundësinë* që ka operatori ekonomik për të siguruar ndihmë shtetërore, çfarë do të thotë që ai mund ta përfitojë ndihmën shtetërore ose jo. Referuar nenit 93 pika 3 të LPP-së autoriteti kontraktor i verifikon këto elemente duke u këshilluar me ofertuesin dhe në bazë të informacionit të paraqitur. Autoriteti kontraktor mund ta refuzojë ofertën, kur edhe pas shqyrtimit të informacionit të paraqitur nga ofertuesi, nuk bindet se ajo është e rregullt në të gjitha elementet e saj. K.P.P gjykon se nga interpretimi teleologjik i normës së mësipërme (qëllimi i saj) lidhet drejtpërdrejtë me shmangien e riskut që mund të sjellë një ofertë e cila rezulton anomalisht e ulët. K.P.P. gjykon se risku që shfaqet në rast se një ofertë rezulton anomalisht e ulët është në disa drejtime, ndër të tjera si: rreziku për moskryerjen e shërbimit/punëve në cilësinë e duhur; rreziku i tërheqjes së operatorit ekonomik nga lidhja e kontratës dhe kostot që i lindin autoritetit nga moskryerja e shërbimit brenda afateve kohore të parashikuara; humbjet që mund të pësojë në kohë nga moskryerja e shërbimit gjatë periudhës së ripublikimit të procedurës së tenderit në rast të moszbatimit të kontratës nga ana e operatorit ekonomik oferta e të cilit rezulton anomalisht e ulët. Gjithashtu, K.P.P. thekson se referuar nenit 2 gërma “b” “Qëllimi” i ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet se; “*Qëllimi i këtij ligji është: b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale*”. Mirëpërdorimi i fondeve publike përfshin jo vetëm përzgjedhjen nga autoriteti kontraktor të ofertave më të ulëta (si kriter i përzgjedhjes së ofertës fituese referuar “çmimit më të ulët”), por gjithashtu shmangien e risqeve dhe dështimin e kontratës, që mund të vijnë nga oferta të cilësuar si anomalisht të ulëta, referuar formulës së përlllogaritjes të parashikuar në ligj. Sa më sipër, referuar rastit në fjalë dhe themelit të kërkimit të operatorit ekonomik ankimes, K.P.P. gjykon vetëm mbi dokumentet e dorëzuara pranë autoritetit kontraktor dhe në rast se këto të fundit përmbushin në mënyrë të detyrueshme katër kushtet e para kumulative të parashikuara nga neni 93 pika 2 i LPP-së, si dhe *mundësinë* për të përmbushur kushtin e pestë, mospërmbushja e të cilit nuk përbën shkak për dështimin e operatorit ekonomik në argumentimin e ofertës anomalisht të ulët.

III.1.7. Nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik “Biometric Albania” SHPK, në mbështetje të ofertës së paraqitur në procedurën e mësipërme të prokurimit, rezulton, se ky i fundit nuk është konform kërkesave të përcaktuara në ligjin dhe rregullat e prokurimit publik. Komisioni i Prokurimit Publik konstaton, se operatori ekonomik “Biometric Albania” SHPK, ka paraqitur si dokumentacion mbështetës ose provues: argumentimin e ofertës në mënyrë narrative përmes shkresës së datës 22.09.2021, listën e çmimeve të kompanisë prodhuese, deklaratë e datës 13.09.2021 e prodhuesit Mindray, por nuk ka paraqitur analizë kostojë të detajuar që të argumentojë kushtet apo elementet, pse kjo ofertë e dalë anomalisht e ulët duhet të pranohet dhe se nuk krijon asnjë rrezik për mosrealizimin me sukses të kontratës. Komisioni i Prokurimit Publik vëren, se operatori ekonomik “Biometric Albania” SHPK, ka paraqitur argumentimin e tij në formën e një sqarimi narrativ. Në këtë kuptim KPP gjykon se shpjegimi narrativ përmes shkresës së datës 22.09.2021, lista e çmimeve të kompanisë prodhuese si dhe deklarata e datës 13.09.2021 e prodhuesit Mindray, të paraqitura nga operatori ekonomik ankimues, nuk janë të mjaftueshme për autoritetin kontraktor për krijimin e bindjes, se ankimuesi disponon kapacitetet e nevojshme për realizimin e kontratës objekt-prokurimi. Gjithashtu Komisioni vëren, se bazuar në shpjegimin narrativ të operatorit ekonomik për ofertën anomalisht të ulët si dhe duke bërë verifikimet me listën e çmimeve të kompanisë prodhuese bashkëngjitur rezulton, se çmimi i blerjes për pajisjen defibrilator në monedhën USD në tabelën e paraqitur nga operatori ekonomik në shkresën e datës 22.09.2021, është i ndryshëm nga çmimi i blerjes që rezulton në listën e çmimeve të kompanisë prodhuese. Gjithashtu operatori ekonomik ka dështuar të provojë me dokumentacion provues shpenzime të tjera shtesë ndër të cilat përfshihen edhe shpenzimet e punonjësve. Operatori ekonomik ankimues ka detyrimin ligjor që të prezantojë me dokumentacion provues katër kushtet kumulative të përcaktuara në nenin 93 pika 2 të lex specialis si dhe *mundësinë* (në rastet kur ai mund të marrë ndihmë shtetërore) për plotësimin e kushtit të pestë, që do të garantonin realizimin e shërbimit pranë autoritetit kontraktor. Bazuar në arsyetimin dhe faktet e shtjelluara më lart, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se nga ana e operatorit ekonomik, oferta e të cilit në zbatim të formulës së përcaktuar në legjislacion ka dalë anomalisht e ulët, janë paraqitur sqarime dhe dokumentacion jo i plotë që të argumentojnë ofertën anomalisht të ulët (në kuptim të: metodës së përzgjedhur, zgjidhjeve teknike të posaçme, apo origjinaliteti i shërbimit të propozuar), duke mos krijuar bindjen se kjo ofertë është e rregullt në të gjitha elementet e saj, me qëllim garantimin e një kontrate të suksesshme. Rrjedhimisht Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se nga ana e operatorit ekonomik ankimues “Biometric Albania” SHPK, nuk është sjellë argumentimi i ofertës anomalisht të ulët në përputhje me nenin 93 pika 2 të LPP-së, ndaj oferta e këtij operatori duhet të skualifikohet nga ana e autoritetit kontraktor.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “Biometric Albania” SHPK nuk qëndron.

Për sa më sipër, në mbështetje të nenit 30 dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi nr.914 datë 29.12.2014 i Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 261, datë 17.03.2010 “Për përcaktimin e tarifës dhe të rregullave për pagimin e saj, në një procedurë ankimi, pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021,

datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Nenit 4 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19” Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

### **Vendos**

1. Të mos pranojë ankesat e operatorit ekonomik “Fedos” SHPK me nr. 1832 prot., datë 29.09.2021 dhe nr.1982 prot., datë 15.10.2021 për procedurën e prokurimit me Nr. REF-97582-06-07-2021, me objekt: Loti 10 – “Pajisje Kardiake” me fond limit 1,676,885.73 lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 16.08.2021 nga autoriteti kontraktor, Qendra Spitalore Universitare Nënë Tereza Tiranë.
  2. Të mos pranojë ankesën e operatorit ekonomik “Biometric Albania” SHPK për procedurën e sipërcituar të prokurimit.
  3. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshme të procedurës së prokurimit.
  4. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet përkatëse për derdhjen në Buxhetin e Shtetit të tarifave financiare të paguara nga operatori ekonomik “Fedos” SHPK.
  5. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet përkatëse për derdhjen në Buxhetin e Shtetit të tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Biometric Albania” SHPK.
  6. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
  7. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

### **KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Nënkryetar**  
**Fiorent Zguro**

**Anëtar**  
**Kreshnik Ternova**

**Anëtar**  
**Anila Malaj**

**Jonaid Myzyri**  
**Kryetar**